



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25 Shkurt 2022

Nr: 99

VENDIM

PËR

LIRIM DHE EMËRIM TË ANËTARËVE TË KZAZ NR. 3, KZAZ NR. 4, KZAZ NR. 5,
QARKU SHKODËR DHE KZAZ NR. 43, QARKU TIRANË

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “ç”, e 2, 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Në bazë të nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, janë kërkuar zëvendësime si më poshtë:

Partia Demokratike e Shqipërisë, me shkresën nr. 1137 prot., datë 22.2.2022, ka kërkuar lirim dhe emërim të anëtarëve të KZAZ nr. 4, qarku Shkodër.

Partia Socialiste e Shqipërisë, me shkresën nr. 1191 prot., datë 22.2.2022, ka kërkuar lirim dhe emërim të anëtarëve të KZAZ nr. 43, qarku Tiranë.

Lëvizja Socialiste për Integrim, me shkresën nr. 1193 prot., datë 24.2.2022, ka kërkuar lirim dhe emërim të anëtarëve të KZAZ nr. 3, KZAZ nr. 4 dhe KZAZ nr. 5, qarku Shkodër.

Propozimet dhe kandidaturat e paraqitura plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 29, pika 1, shkronja “c”, 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.



PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “ç”, e 2, 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

VENDOSI:

1. Të lirojë nga detyra anëtarët e KZAZ nr. 3, z. Ilir Gojani (LSI), KZAZ nr. 4, z. Klodian Nasa (LSI) dhe zj. Roza Rupa (PD), KZAZ nr. 5, z. Gjozef Kulla (LSI), qarku Shkodër, si dhe KZAZ nr. 43, z. Reshit Kala (PS), qarku Tiranë.
2. Të emërojë anëtarët e KZAZ nr. 3, z. Gentian Ibroja (LSI), KZAZ nr. 4, z. Ergys Ivziku (LSI) dhe zj. Sevjola Hasani (PD), KZAZ nr. 5, z. Ardjan Brunga (LSI), qarku Shkodër, si dhe KZAZ nr. 43, z. Redon Beti (PS), qarku Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

